



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 3090

Nr.

Nr. 2852 Vendimi

Dt.Rregj 01.07.2021/27.09.2021

1817/

3090

NR. VENDIMI 2852

AKTI

DT.29.10.2021

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTAR - ARBEN MICKAJ

Asistuar prej sekretares **Merita Drishti**, në Tiranë, sot, më datë 29.10.2021 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, me gjykim të shkurtuar, çështjen penale me Nr.3090 akti, që i përket;

KËRKUESE: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane e përfaqësuar nga **prokuror Artan Lulaj**.

I PANDEHUR: **Ermal Roçi**, identifikuar me anë të kartës ID-I40311015I i biri i Shefqetit dhe Mefase, i datëlindjes 11.03.1984, lindur dhe banues në Komuna Kujan-Elbasan me arsim 8 klase, me shtetesi shqiptare. Mbrojtur në gjykim nga av. Ilir Murati me nr.1216 license dhe Nipt K61912001V, anetar i Dhomes së Avokatise Tirane.

I AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, të parashikuar nga neni 283/1 dhe 189 i K.Penal.

Në përfundim të gjykimit zhvilluar në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë Artan Lulaj, të pandehurit Ermal Roçi dhe Av. Ilir Murati, Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes, çmoi dhe vlerësoi në tërësi provat e marra në seancë gjyqësore nënshtruar rregullave të gjykimit të shkurtuar dhe dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët, të cilët kërkuan:

Prokurori:

- Deklarimin fajtor të pandehurit Ermal Roçi për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe dënimin e tij me 5(pesë) vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të pandehurit Ermal Roçi për veprën penale të “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” parashikuar nga neni 189 i K.Penal dhe dënimin e tij me 6(gjashtë) muaj burgim.
- Në aplikim të nenit 55 të K.Penal, dënimin e pandehurit me 5(pesë) vjet burgim.
- Në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e 1/3 së dënimit duke e dënuar të pandehurin

Ermal Roçi me 3(tre) vjet e 4(katër) muaj burgim.

- Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale, asgjesimin e lëndës narkotike të sekuestruar dhe dokumentit të falsifikuar.

I pandehuri Ermal Roçi dhe avokati i tij Ilir Murati:

- Aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale dhe uljen e 1/3 së dënimit që do të caktohet nga gjykata.
- Aplikimin e nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit dhe vendosjen në kohë prove për një periudhë prej 2(dy) vitesh

Si dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN SE:

I. Procedura

1. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga ana e organit të prokurorisë është paraqitur për gjykim çështja penale në ngarkim të të pandehurit Ermal Roçi, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Mbajtja, shitja pa leje e lëndëve narkotike” dhe “Falsifikimi i pasaportave, leternjoftimeve ose vizave”, të parashikuar nga neni 283/1 dhe 189 i K.Penal.

2. Fillimisht, Gjykata morinë shqyrtim kryesisht *juridiksionin dhe kompetencën* për gjykimin e kësaj çështjeje penale. Juridiksioni gjyqësor penal përcaktohet nga neni 69 i K.Pr.Penale, ku shprehimisht parashikohet se: *“Juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë kod.”* Duke qenë kështu, Gjykata konstaton se ka juridiksion për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Gjithashtu, në përputhje me nenet 74 e 76/1 të K.Pr.Penale, Gjykata çmon se ka kompetencë tokësore e lëndore dhe ka vendosur gjykimin e saj.

3. Para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, në fazën procedurale të parashtrimit të kërkesave paraprake i pandehuri nëpërmjet mbrojtësit të tij, në bazë të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale ka paraqitur një kërkesë, duke kërkuar që të procedohej me gjykim të shkurtuar, duke menduar se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet.

4. Në rastin konkret, Gjykata çmon se kërkesa për gjykim të shkurtuar është paraqitur në fazën e duhur procedurale. Pasi mori edhe mendimin e prokurorit dhe pas shqyrtimit të të gjitha akteve të ndodhura në fashikullin e gjykimit, ku konstatoi se ato nuk përmbanin ndonjë pavlefshmëri nga ato të parashikuara në nenin 128 të K.Pr.Penale, Gjykata, vlerësoi se bazuar në nenin 404 të Kodit të Procedurës Penale, ka vend për të proceduar me gjykim të shkurtuar, pasi çmoi se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa cënuar dhënien e drejtësisë.

5. Gjykimi i shkurtuar, si gjykim i posaçëm, në thelb eviton fazën e hetimit gjyqësor dhe i pandehuri pranon gjendjen e akteve të përfshira nga prokurori në fashikullin e gjykimit i cili më pas kthehet në dosjen gjyqësore me vendim të gjykatës. Në këtë lloj gjykimi as nuk debatohej provat e paraqitura nga prokurori në dosje dhe as nuk paraqiten prova të reja. Edhe në këtë proces gjyqësor nuk u debatuan provat e dosjes së prokurorit dhe as nuk u paraqitën prova të reja nga prokurori apo i pandehuri.

I. Rrethanat e çështjes:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane, mbi bazën e materialit kallzues të derguar nga Drejtoria Vendore Policise Trane, ka regjistruar kallezimin penal nr.16681/2020, për kryerjen e veprës penale të “Prodhim dhe shitje narkotikesh”, “Falsifikimi i pasaportave, vizave ose leternjoftimeve”, “prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municioneve”,

“prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve te gjuetise ose sportive”, te parashikuar nga n.283/2, 189,278/5 dhe 280 K.Penal, ne ngarkim te shtetasve Ermal Roçi dhe Nertila Roçi.

Nga studimi i materialeve të referuara nga policia gjyqësore rezulton se, Me date 26.12.2020, rreth ores 17.30, nga punonjesit e Forces se Posacme Operacionale,te Drejtorise se Forces se Posacme Operacionale,ne Drejtorine e pergjithshme te Policise se Shtetit, duke qene te planizuar me sherbim ne autostraden Tirane-Durres, ne afersi te mbikalimit tek Casa Italia, kane morre informacion se po udhëtonte me drejtimin Durres-Tirane, një automjet tip autoveturë, të markës Peugeot, me ngjyre blu, me targe AA272NL, dhe persona në të posedonin lende narkotike si dhe municion. Nga shërbimet e Forces se Posacme Operacionale,ne Drejtorine e pergjithshme te Policise se Shtetit, është njoftuar dhe një shërbim i Seksionit të Forcës së Posaçme Shigjeta të DVP Tiranë dhe rreth orës 17:43, kanë bërë ndalimin e këtij automjeti me drejtues Ermal Roçi dhe pasagjer Nertila Roçi, dhe gjatë kontrollit në xhepin e derës u gjet një kuti kartoni brenda të cilës kishte një mbajtëse plastike me ngjyrë të zezë në të cilën ndodheshin 50 (pesëdhjetë) copë fishekë, me ngjyrë gri (metalixato), ku në pjesën e sipërme të tyre nuk ka predhë por një vrimë e cila brenda saj ka material si plastike me ngjyrë jeshile, po kështu në automjet u gjet dhe një kuti metalike rrethore, me mbishkrim ne pjesen e sipërme te saj :”Magnum cal.4,5 (177)” “Super ak.Oztay Magnum”, brenda të cilës kishte saçme me ngjyre metalike me maje ne pjesen e sipërme te tyre. Gjatë kontrollit fizik të shtetasës Nertila Roçi i’u gjet një qese plastike transparente, e mbyllur me djegie, brenda të cilës kishte material pluhur me ngjyrë të bardhë në formë kokrrizash të ngurtësuar, të dyshuar si lëndë narkotike Kokainë. Pasi u bë sekuestrimi lëndës të dyshuar narkotike të llojit Kokainë, u bë peshimi i saj dhe rezultoi me peshë të përgjithshme **10.2 (dhjetë pikë dy)** gram, e cila pas peshimit u fut në qesen e provave me **Nr.UNIK. A20003696**.

Më pas nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan është ushtruar kontroll në banesën e Ermal Roçi dhe Nertila Roçi në Elbasan, Njësia Administrative Kajan, fshati Turbull dhe gjatë kontrollit janë gjetur dy pushkë njëra si ato sportive dhe tjetra e dyshuar si armë zjarri pushkë e modifikuar, një qese farmaceutike transparente dhe një qese me ngjyrë blu, të cilat janë me lëndë të dyshuar narkotike Cannabis Sativa, dy dokumenta të dyshuara të falsifikuara në gjuhën Greke, ku njëri është me numër AM091753 me mbishkrim “IDENTITY CARD” kurse tjetri në dukje patentë Greke, me mbishkrim “KONSTANTINOS KAISIDIS, nr.530406180, A,B”.

Pasi u bë sekuestrimi i lëndës të dyshuar narkotike të llojit Cannabis Sativa, u bë peshimi i saj dhe rezultoi me peshë të përgjithshme **132.8 (njëqind e tridhjetë e dy pikë tetë)** gram, e cila pas peshimit u fut në qesen e provave me **Nr.UNIK. B20001870**.

Është pyetur në cilësin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime shtetasi Ermal Roçi, i cili ka deklaruar se ne lidhje lëndën narkotike Kokainë që i’u gjet bashkëshortes së tij ai deklaroi se ajo është e tij pasi është përdorues i lëndës narkotike Kokainë dhe e ka blerë për ta përdorur vetë. Ai deklaroi se lëndën narkotike Kokainë ja ka dhënë bashkëshortes tij Nertilës dhe ajo nuk e dinte se çfarë ishte. Në lidhje me Hashashin që u gjet në banesë ai deklaroi se dhe atë e ka pasur për përdorim vetijak pasi përdor herë pas herë lëndë narkotike Cannabis Sativa. Për dy dokumenta që janë gjetur në banesë në gjuhën Greke ai deklaroi se ato i ka bërë në Greqi para rreth 5-6 vitesh dhe i përdorte në Greqi, ato dokumenta i kishte harruar në shtëpi pasi nuk janë më të vlefshme. Ato dy pushkët nuk janë armë zjarri dhe në dijenin e tij nuk duan ndonjë

leje të posaçme. Lëndën narkotike Kokainë që i'u gjet bashkëshortes tij e ka blerë me datë 26.12.2020 në autostradë diku afër Vorës tek një person që nuk e njohte por e dinte se ai shiste. Ky person që i shiti lëndën narkotike ishte i moshës rreth 30 vjeç, trup mesatar, rracë e bardhe, floke gështenjë, me shumë të dhëna për këtë person nuk mban mend.

Është pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime shtetasia Nertila Roçi, e cila ka deklaruar se në lidhje me lëndën narkotike Kokainë që i'u gjet asaj ajo deklaron se atë i'a ka dhënë bashkëshorti në momentin e fundit që është afuar policia por unë nuk i dinte gjë se çfarë ishte kurse për Hashashin në shtëpi nuk e ka ditur që ishte në shtëpi por e di që bashkëshorti e pi ndonjë cigare Hashash, pushkët në dijeninë e saj i ka pasur mbajtur burri njëherë e ka mbajtur për bukuri pasi është si antike kurse tjetra është me ajër.

U përpiluan vendimet përkatëse të ekspertimit kimik, teknik të pushkëve dhe fishekëve, teknik-dokumenti dhe toksikologjik.

Është administruar akti ekspertimit kimik nr.342 datë 14.0.2021, në përfundim të të cilit ekspertët kanë konkluduar se : “Analiza me GC/MS për pluhurin objekt ekspertimi tregoi praninë e kokainës. 2-pesha pa ambalazh e pluhurit objekt ekspertimi është 9.830 (nëntë pik tetëqind e tridhjet) gram.

Është administruar akti ekspertimit kimik nr. 343/2021, në përfundim të të cilit ekspertët kanë konkluduar : “Materili bimor objekt ekspertimi janë cannabis sativa, produkt herbal bimë cannabis sativa L. Pesha në total pa ambalazh e lëndës objekt ekspertimi është 121.916 (njëqindnjëzet e një pik nëntëqindgjatëmbëdhjet) gram.

Është administruar akti ekspertimit teknik të fishekëve nr.397/2020, në përfundim të të cilit ekspertët kanë konkluduar se “Fishekët objekt ekspertimi janë fishek që shërbejnë për municion për pistoleta speciale, imitim zhurmash dhe të gazrave, kalibër 9mm. Fishekët janë në gjëndje të rregullt teknike dhe realizojnë qitje. Këta fishek nuk futen në kategorinë e fishekëve luftarak”.

Është administruar akti e ekspertimit teknik-balistik të armëve nr. 396 datë 11.01.2021, në përfundim të të cilit ekspertët kanë konkluduar “Pushka objekt ekspertimi me nr.38/789, është armëpneumatike kalibër 4.5mm, (neni 3, pika 11, Ligji nr.74/2004), që funksionon me parimin e ngjeshjes së ajrit. Pushka objekt ekspertimi është në gjëndje të rregullt teknike dhe realizon qitje normalisht. 2- Pushka objekt ekspertimi pa numër me mbishkrimime, është pushkë sportive, kalibër 5mm, që përdor si municion fishekë sportiv kalibër 5mm. Pushka objekt ekspertimi është në gjëndje të parregullt teknike dhe nuk realizon qitje, (i mungon gjilpëra) metalike)

Është administruar akti ekspertimit teknik të dokumentave nr. 24 datë 06.01.2021. në përfundim të të cilit ekspertët kanë konkluduar “Dokumenti kartë identiteti greke ME NR. Am091753, objekt ekspertimi në emër të shtetasit Kostandinos kaisidis, është tërësisht e fallsifikuar. – Fallsifikimi konsiston në riprodhimin e dokumentit me anë të makinave fotokopjuese duke përfshirë skanimin dhe më tej imitime të disa prej elementëve të sigurisë.

“Dokumenti leje drejtimi greke ME NR.152806975, objekt ekspertimi në emër të shtetasit Dorjan Qirjazi, është tërësisht e fallsifikuar. – Fallsifikimi konsiston në riprodhimin e dokumentit me anë të makinave fotokopjuese duke përfshirë skanimin dhe më tej imitime të

disa prej elementëve të sigurisë, me natyrë fluoreshente.

Janë administruar aktet e ekspertimit toksikologjik nr.57 dhe 59 vitit 2021

Nga sa më sipër rezulton plotësisht e provuar se i pandehuri Ermal Roçi, ka konsumuar elementet e veprës penale të “prodhimi dhe shitje e narkotikeve”, “falsifikimit të pashaportave, vizave”, parashikuar nga neni 283/1, 189 Kodit Penal.

I. Legjislacioni i zbatueshëm:

“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal

Neni 283 “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, i cili parashikon:

“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet”.

Neni 189 “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”i cili parashikon:

“Falsifikimi ose përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave apo i vizave të falsifikuara dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën apo vizën, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet”.

Neni 55 i K.Penal, “Caktimi i dënimeve për disa vepra penalei cili parashikon:

“Kur veprimet ose mosveprimet përmbajnë elementët e disa veprave penale, si dhe kur personi ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma vendim, gjykata më parë cakton dënimin për çdo vepër penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar.

Dënimi më i rëndë i shtuar në rastin kur personi ka kryer një krim kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, përbëhet nga shuma e përgjithshme e dënimeve për secilën vepër penale.

Dënimi më i rëndë i shtuar nuk mund të kapërcejë shumën e përgjithshme të dënimeve të caktuara veç e veç, as kufirin më të lartë të parashikuar për llojin e dënimit të dhënë.

Kur gjykata çmon se kryerja e shumë veprave penale nuk tregon rrezikshmëri të madhe të fajtorit, mund të japë si dënim përfundimtar dënimin më të rëndë që ka caktuar për një nga veprat penale.

Gjykata në vendimin përfundimtar jep një ose më shumë nga dënimet plotësuese të dhëna më vete për çdo vepër të veçantë.

Neni 406 të K.Pr.Penale “Vendimi” i cili parashikon: “1. Kur jep vendim dënimi gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën.”

Neni 390/1 i K.Pr.Penale parashikon: “Kur i pandehuri del fajtor për veprën penale që i atribuohet gjykata jep vendim dënimi, duke caktuar llojin dhe masën e dënimit.”

I. Arsyetimi i gjykatës:

6. Parakushti i marrjes së një personi në përgjegjësi penale për një veprim apo mosveprim të kundraligjshëm është ekzistenca e katër elementëve të saj objektivë dhe subjektivë të përcatuar nga legjislacioni penal. Kështu, nëlidhje me të pandehurin, Ermal Roçi, Gjykata çmon se ai ka kryer veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe se plotësohen të gjithë elementët e figurës së kësaj vepre penale për arsyet simë poshtë:

7. Vepra penale e parashikuar nga neni 283 i kodit penal (*Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike*), ka për **objekt** marrëdhëniet juridike të vendosura në mbrojtje të rregullave për shitjen, dhënien, marrjen dhe mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope. Në rastin konkret i pandehuri Ermal Roçi nëpërmjet mbajtjes së lëndës narkotike ka cënuar objektin e kësaj vepre penale.

8. Ajo që merr rëndësi në cilësimin sipas kësaj dispozite është **ana objektive**. Vepra nga ana objektive, kryhet me anë të veprimeve/mosveprimeve të kundërligjshme, ose në kapërcim të autorizimit ligjor dhe në disa forma të parashikuara specifikisht në paragrafin e parë të dispozitës. Konkretisht, përmes *shitjes, ofrimit për shitje, dhënies, marrjes në çdo formë, shpërndarjes, tregtimit, transportimit, dërgimit, dorëzimit, si dhe mbajtjes përveç përdorimit vetjak në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre*. Lidhur me formën e mbajtjes, ligjvënësi, si kriter përcaktues për marrjene personit në përgjegjësi penale, ka parashikuar dy rrethana specifike:

- Së pari, mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe të farëve të bimëve narkotike jo për përdorim vetiak.
- Së dyti, ato nuk duhet të jenë në doza të vogla.

9. Në lidhje me këto dy kushte, kërkohet që ti nënshtrohen procesit të provuarit dhe në bazë të aktit të ekspertimit, sasia e gjetur prej 10.2 (dhjetë pikë dy) gram lënde narkotike e llojit Kokainë dhe 132, 8 (njëqind e tridhjetë e dy pikë tetë) gram lëndë narkotike e llojit Cannabis Sativa nuk vlerësohet të jetë për përdorim vetjak dhe dozë e vogël sipas kuptimit që i jep ligji për të bërë të mundur përjashtimin nga përgjegjësia penale.

10. Sa më sipër Gjykata vlerëson se i pandehuri me anë të veprimeve të tij të kundërligjshme ka përmbushur anën objektive të përcaktuar nga neni 283 i Kodit Penal në formën e mbajtjes. Gjykata vlerëson se qëllimi i shitjes i mbetur në tentativë sipas pretendimit të Prokurorit nuk u arrit të provohet në këtë proces.

11. Subjekti i kësaj vepre është i përgjithshëm dhe duhet të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe të jetë i përgjegjshëm. I pandehuri, Ermal Roçi i plotëson të dyja këto kushte për t’u konsideruar subjekt i veprës penale: ai ka qenë dhe është i përgjegjshëm, si dhe në momentin e kryerjes së veprës penale pra e ka pas mbushur moshën e kërkuar nga neni 12 i K.Penal.

12. Nga **ana subjektive vepra penale e parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal kryhet** me dashje të drejtëpërdrejtë dhe pavarësisht se nuk shprehet në dispozitë vepra kryhet për qëllim

përfitimi material. Gjykata çmon se plotësohet edhe ana subjektive pasi i pandehuri pasi ai ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm dhe shoqërisht të rrezikshëm të veprës penale

13. Sa më sipër Gjykata, nga teresia e provave të administruara në gjykim, ka rezultuar e provuar se i pandehuri Ermal Roci ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, “*Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike*” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.

14. Më tej, në lidhje me kërkimin e dytë të organit të prokurorisë, Gjykata çmon se i pandehuri me veprimet të tij të kundërligjshme ka përmbushur edhe elementët e figurës së veprës penale të “Falsifikimit të letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” i parashikuar nga Neni 189i K.Penal, për këto arsye:

15. **Së pari**, i pandehuri Ermal Roçi me anë të veprimeve të tij konkretisht përdorimit të dokumentave të falsifikuara, ka cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligje, për të siguruar veprimtarinë e rregullshmërinë e lëshimit apo të përdorimit të letërnjoftimeve, kartës së identitetit, pasaportave apo vizave, saktësinë e këtyre dokumentave të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet apo mosveprimet kriminale (**objekti veprës penale**).

16. **Së dyti**, që të ndodhemi para kësaj vepre penale duhet që nga ana objektive të kryhet një nga këto veprime: a) falsifikimi i këtyre akteve me mënyra të ndryshme dhe b) me anë të përdorimit të këtyre dokumentave të falsifikuara. I pandehuri Ermal Roçi është ndaluar në posedim të dy dokumentave në gjuhën greke, kartë identiteti hreke me numër Am091753 e vila sipas aktit të ekspertimit rezulton tërësisht e falsifikuar dhe leje drejtimi greke me Nr 152806975 e cila gjithashtu sipas aktit të ekspertimit rezulton tërësisht e falsifikuar. Si rrjedhim, i pandehuri e ka kryer veprën penale nga **ana objektive** në formën e përdorimit të dokumentave të falsifikuara.

17. **Së treti**, i pandehuri duhet të plotësojë kushtet për t’u konsideruar **subjekt i veprës penale**. Subjekti i veprës penale quhet personi që ka mbushur moshën e caktuar me ligj për përgjegjësi penale dhe që është i përgjegjshëm. Kështu, në rastin e veprës penale të parashikuar nga neni 189 i K.Penal, sipas nenit 12 të K.Penal duhet të ketë mbushur moshën 14 vjeç dhe të jetë i përgjegjshëm. I pandehuri i plotëson të dyja këto kushte për t’u konsideruar subjekt i veprës penale: ai ka qenë dhe është i përgjegjshëm, si dhe në momentin e kryerjes së veprës penale pra e ka pas mbushur moshën e kërkuar nga neni 12 i K.Penal. Në këto kushte, i pandehuri është subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 189 i K.Penal.

18. **Së katërti**, duhet të ekzistojë edhe **ana subjektive**, që është një element kryesor dhe i domosdoshëm i figurës së veprës penale, e cila përfaqëson pjesën e brendshme të saj. Kështu, kur flasim për anën subjektive i referohemi fajit, motivit dhe qëllimit. Në rastin konkret, veprimet e të pandehurit duhet të kryhen me dashje direkte, ndërsa qëllimi dhe motivi nuk kanë rëndësi për kualifikimin e veprës penale. Kështu, në plotësim të këtij elementi gjykata çmon se i pandehuri, ka vepruar me dashje të drejtëpërdrejtë, pasi ai ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm dhe shoqërisht të rrezikshëm të veprës penale “Falsifikimit të letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” dhe me ndërjegje ka vepruar, duke i vënë ato në përdorim.

19. Sa më sipër u arsyetua, Gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri Ermal Roçi, duhet të deklarohet fajtor edhe për veprën penale “Falsifikimit të letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, parashikuar nga neni 183/1 i Kodit Penal.

20. Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit, Parimet dhe kriteret e përgjithshme të caktimit të dënimit janë përcaktuar në nenin 1/c të K.Penal, i cili parashikon se “*Kodi penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit.*” Në këtë mënyrë, gjykata

paraprakisht duhet të ketë parasysh që të caktojë një dënim që, nga njëra anë, është i aftë të përmbushë qëllimin për të cilin është krijuar ky institut juridik, ndëshkimin, dhe nga ana tjetër, të jetë njëkohësisht i aftë të parandalojë në të ardhmen sjelljet kriminale të të dënuarit dhe ta riedukojë atë.

21. Gjykata për të caktuar llojin dhe masën e dënimit në rastin konkret i referohet edhe nenit 47 të Kodit Penal që parashikon se “*Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.*” Në këtë dispozitë është parashikuar ai që njihet si parimi i individualizimit të dënimit, i cili është një nga parimet themelore që udhëheq gjykatën në caktimin e dënimit. Duke u bazuar në këtë dispozitë le të marrim në trajtim të gjitha kriteret dhe rregullat që duhet të marrë për bazë gjykata për dhënien e llojit dhe masës së dënimit në rastin konkret:

22. *Rrezikshmëria e veprës penale*: Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale përcaktohet në kuadër të objektit të saj si dhe nga tërësia e elementëve objektiv e subjektiv që e formojnë. Pra, përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lidhet me natyrën dhe llojin e veprës penale, me masat e dënimit që përcakton neni përkatës, me përhapjen e saj, rëndësinë e marrëdhënieve juridike që prek, mënyrën dhe formën e kryerjes së veprës penale. Gjykata vlerëson se vepra penale e parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, ka rrezikshmëri shoqërore të lartë për shkak se cënon ato marrëdhënie që sigurojnë mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike. Marzhi i dënimit që parashikohet nga vetë dispozita flet për rrezikshmërinë e veprës e cila dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet

23. *Rrezikshmëria shoqërore e personit (autorit)* Ermal Roçivlerësohet e lartë pasi i pandehuri rezultoi se ka kryer më shumë se një vepër penale ku përvec Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, gjykata e ka gjetur fajtor edhe për veprën penale të “Falsifikimit të letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” sipas nenit 189 të K.Penal

24. *Shkalla e fajit* të autorit përcaktohet nga faktorë e rrethana të lidhura ngushtë me rrezikshmërinë shoqërore që paraqet vetë personi dhe vepra e kryer prej tij. Sa më sipër rezultojnë që shtetasi Ermal Roci të gjitha veprimet e kundërligjshme i ka kryer me dashje. Ai ka patur dijeni për paligjshmërinë e veprimeve të kryera dhe me vetëdije i ka realizuar ato.

25. Për sa më sipër, në një vlerësim të hollësishëm të përmbajtjes, konstatimeve si dhe të gjitha rrethanave të kryerjes së veprës penale nga i pandehuri, Gjykata konkludoi se lloji i dënimit me burgim për të pandehurin Ermal Roçi, i kërkuar nga organi i akuzës është në raport të drejtë me vlerësimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale dhe do të realizojë njëkohësisht jo vetëm qëllimin e ndëshkimit të të pandehurit për veprën penale të kryer, por edhe atë të rehabilitimit, edukimit dhe ri-integrimit të të pandehurit në shoqëri. Gjykata pasi ka marrë në trajtim të gjitha kriteret e mësipërme, çmon se ndaj të pandehurit Ermal, duhet të caktojë dënimin përfundimtar prej 5 (pesë) vite burgim në lidhje me veprën penale tëparashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, dhe 6 (gjashtë)muaj burgim për veprën penale të “Falsifikimit të letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” të parashikuar nga neni 189 i K. Penal.

26. *Në lidhje me shtetasen Nertila Roci*, siç rezultojnë edhe nga provat e listuara më sipër, ajo nuk ka patur dijeni për asnjë nga veprimet e kryera nga bashkëshorti i saj por ka marrë dijeni për faktin se qeset përmbajnë në brendësi lëndë narkotike vetëm pas ndalimit të tyre nga punonjësit e policisë. Në rastin konkret marrja dijeni pas ndalimit nga forcat e policisë nuk sjell përgjegjësi penale për të.Gjithashtu edhe për sendet e gjendura në banesë ajo nuk ka detyrimin për të kallëzuar dhe përjashtohet nga përgjegjësia penale.

27. Nga analiza e mësipërme, referuar nenit 387/1 i cili përcakton se “kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, gjykata vendos pushimin e çështjes”, gjykata arrin në konkluzion se nuk provohet që e pandehura të ketë kryer ndonjë veprim të paligjshëm në kuptimin penal, atëherë nuk kemi as faj, pasi mungon si elementi intelektual ashtu dhe ai volutiv, që të ekzistojë faji si element thelbësor i përgjegjësisë penale.

28. Përfundimisht, në lidhje me shtetasen Nertila Roçi gjykata e pranon kërkesën e organit të akuzës dhe vendos për pushimin e çështjes penale nr 9171 datë 27.12.2020 në ngarkim të saj.

29. Gjykata vlerëson se bazuar në nenin 190 të K.Pr.Penale duhet të shprehet edhe provat materiale sipas kërkimit të organit procedues. Në lidhje me këtë disponim gjykata vlen të theksojë se nga organi procedues u kërkua ndër të tjera që gjykata të shprehet në lidhje me provat materiale. Për pasojë, gjykata urdhëron asgjësimin e lëndës narkotike të sekuestruar dhe dokumentit të falsifikuar.

30. Në lidhje me shpenzimet gjyqësore, bazuar në nenin 393 paragrafi 1 dhe në nenin 485 të K.Pr.Penale, shpenzimet proceduriale të fazës së hetimit në shumën 1000 lekë, si dhe shpenzimet gjyqësore në masën 1,500 lekë i ngarkohen të pandehurit

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të neneve 379, 382, 383, 384, 390, të K.Pr.Penale, Gjykata,

V E N D O S I

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ermal Shefqet Roci** për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe dënimin e tij me **5(pesë) vjet burgim**.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ermal Shefqet Roci** për veprën penale të “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” parashikuar nga neni 189 i K.Penal dhe dënimin e tij me **6(gjashtë) muaj burgim**.
- Në zbatim të nenit 55 të K.Penal, bashkimin e dënimeve dhe dënimin e të pandehurit **Ermal Shefqet Roci** me një dënim të vetëm prej **5(pesë) vitesh burgim**.
- Në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e 1/3 së dënimit të të pandehurit **Ermal Shefqet Roci** duke e dënuar me **3(tre) vjet e 4(kater) muaj burgim**.
- Në bazë të nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit prej 2 vjet e 25 ditë dhe vendosjen në kohë prove për një periudhë prej 3(tre) vitesh me kusht që i pandehuri të mos kryej veprë tjetër penale si dhe detyrimin e të pandehurit që të mbaj kontakt me Shërbimin e Provës.
- Shuarja e masës së sigurimit “Arrest ne burg”, për të **pandehurin Ermal Shefqet Roci** të dhënë me vendimin nr.2135 Akti, datë 29.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i tëpandehurit Ermal Shefqet Roci nga ambientet e burgut Fushë-Krujë nëse nuk mbahet për ndonjë tjetër masë sigurimi apo vendim të formës së prerë.
- Pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasës Nertila Roci, për veprat penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” dhe “Podhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, të parashikuara përkatësisht nga

nenet 283/2, 189/2 dhe 278/3,5 dhe 280 të K.Penal.

- Në përputhje me nenin 190 të K.Pr.Penale, asgjesimin e lëndës narkotike të sekuestruar dhe dokumentit të falsifikuar.
- Të ngarkohet i pandehuri për pagimin e shpenzimeve procedurale.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga palët brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.
- U shpall në Tiranë sot në datë 29.10.2021.

SEKRETARE

**MERITA DRISHTI
MICKAJ**

G J Y Q T A R

ARBEN

Shpenzime të prokurorisë

Nuk ka

Shpenzime gjyqesore

Nuk ka